

Raste me COVID-19 në qarqet Dibër dhe Fier


Gjatë kësaj jave (deri më 29 maj), në të dy qarqet ka pasur raste të reja infektimi me COVID-19, përkatësisht 6 raste në qarkun Dibër dhe 4 raste në qarkun Fier. Stafet e NjVKSH-ve përkatëse po kryejnë hetimin epidemiologjik përmes gjurmimit të personave të kontaktit ndërkohë që profesionistët e kujdesit shëndetësor parësor po monitorojnë gjendjen shëndetësore të personave të infektuar dhe izoluar në shtëpi.



Udhëzime nga autoritetet shëndetësore

- Në poliklinikat e specialiteve në të dy qarqet kanë rinisur vizitat e mjekëve specialistë në përputhje me urdhërin e lëshuar më herët nga Drejtoria Qendrore e Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor. Në këtë kuadër, mjekët e familjes janë pajisur me udhëzuesin "Për referimin tek mjekët specialistë në periudhën e pandemisë nga SARS-CoV-2".
- Drejtoria Rajonale e FSDKSH në Dibër vijon zhvillimin e trajnimeve në grupe të vogla për mjekët e familjes lidhur me regjistrimin elektronik të konsultave të pacientëve. Në këtë kuadër, HAP ka mbështetur mjekët e familjeve të disa qendrave shëndetësore duke siguruar pjesën logjistike.

Mirë se erdhët në portalin e mjekut të familjes!



Gjatë trajnimit me mjekët e familjes (foto nga FSDKSH)

Mbështetja e HAP

HAP-i për pesë javë rresht ka publikuar në formën e materialeve trajnuese-informuese për personelin shëndetësor dhe publikun përgjigjet për pyetjet që bëhen shpesh rreth COVID-19.

Këtë javë HAP-i fillon publikimin e materialeve trajnuese lidhur me ndikimet në shëndetin mendor të publikut dhe punonjësve shëndetësorë të epidemisë së COVID-19.




Shëndet për të Gjithë është një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim i cili po zbatohet nga Instituti Zviceran i Shëndetit Publik dhe Mjekësisë Tropikale



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Agjencia Zvicerane për Zhvillim
dhe Bashkëpunim SDC



REPUBLIKA E SHQIPËRIE
MINISTRIA E SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE

Swiss TPH



Swiss Tropical and Public Health Institute

Përshtatja e shërbimeve të KSHP-së: bashkëpunimi në nivel lokal

Një histori e suksesshme bashkëpunimi në nivel lokal këtë herë vjen nga Bulqiza ku, ndër të tjera, një akt-marrëveshje për bashkëpunim ndër-institucional u firmos mes Bashkisë, NjVKSH-së dhe Zyrës Arsimore që në ditët e para të pandemisë. Synimi i akt-marrëveshjes ishte marrja e masave higjeno-sanitare për parandalimin e përhapjes së sëmundjeve respiratore dhe të COVID-19 në institucionet parashkollore, kopshte, cerdhe dhe institucionet të tjera arsimore. Ne biseduam me Z. Flamur Meta, drejtor i NjVKSH Bulqizë, i cili na tregon edhe për aspekte të tjera të bashkëpunimit në Bulqizë *“Kemi bashkëpunuar me policinë e rendit, policinë bashkiake organizuam grupe të përbashkëta, përfshirë personelin e NjVKSH-së, që të monitoronim zbatimin e rregullave të karantinimit nga qytetarët dhe zbatimin e kriterëve të higjienizimit dhe distancimit social për subjektet shtetërore dhe private që ofronin shërbime publike në komunitet gjatë karantinës.”*



Ekipi i NjVKSH Bulqizë gjatë punës për ndërgjegjësimin e qytetarëve për COVID-19

Z. Meta thekson gjithashtu bashkëpunimin e mirë me Bashkinë Bulqizë, grupet e emergjencës të ngritur në çdo njësi administrative dhe personelin e qendrave shëndetësore për dërgimin e barnave të rimbursueshme tek 2918 pacientë kronikë. Gjithashtu, Z. Meta na tregon se si i ka ndihmuar bashkëpunimi i mëparshëm dhe ai aktual me HAP: *“Gjatë punës për ndërgjegjësimin e qytetarëve në këtë periudhë pandemie, na ka ndihmuar shumë bashkëpunimi i mëparshëm me Projektin Shëndet për të Gjithë, lidhur me trajnimet që janë realizuar për promocionin shëndetësor. Mbështetja dhe bashkëpunimi është fokusuar në zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme ndërgjegjëse, të organizuara posaçërisht në komunitet dhe me grupe të vecanta, më vulnerabël. Synimi ka qenë rritja e mundësisë së aksesimit të tyre në marrjen e plotë të shërbimit shëndetësor parësor, me synim mbulimin shëndetësor universal në komunitet. Aktualisht, bashkëpunimi që kemi me HAP për procesin e akreditimit të disa qendrave shëndetësore në Bulqizë, është një eksperiencë shumë e dobishme sidomos lidhur me organizimin e punës dhe zbatimin e protokolleve me fokus parandalimin dhe kontrollin e infeksioneve, çka ka qenë shumë e nevojshme në këto kohë të përballjes me COVID-19.”*



5 momentet e mia për higjenën e duarve

Përdorni solucion me bazë alkooli për të pastruar duart ose lajini ato me sapun dhe ujë:

